



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

THIRRJE PUBLIKE

PËR MBËSHTETJE FINANCIARE PËR PROJEKTPROPOZIME TË
ORGANIZATAVE JOQEVERITARE, INDIVIDËVE DHE BIZNESEVE, NË
FUSHAT: *Art vizual – figurative, Trashëgimi kulturore dhe turizëm, Shoqëri
Kulturore Artistike, Mbështetje të organizatave vjetore dhe operatorëve
Kulturore si dhe Botime*

Udhëzimet për aplikues

Data e hapjes së thirrjes: më 29.03.2024

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve: më 24.04.2024

PROBLEMET TË CILAT SYNOHET TË ADRESOHEN PËRMES KËSAJ THIRRJE PUBLIKE

Komuna e Prishtinës kujdeset për jetën kulturore të kryeqytetit dhe me këtë synim ofron përkrahje për OJQ, biznese dhe individë, programi i të cilëve është i fokusuar në fushën e kulturës.

Në këtë vijë, Komuna e Prishtinës synon pasurimin e jetës kulturore të qytetit, rritjen e llojllojshmërisë së aktiviteteve, tërheqjen e numrit sa më të madh të publikut në aktivitete, tërheqjen e turistëve në këto aktivitete të krijuara, si dhe në promovimin e kulturës dhe aktiviteteve të gjithë qytetarëve.

OBJEKTIVAT E THIRRJES DHE PRIORITETET PËR NDARJEN E FONDEVE

Objektivi/objektivat e përgjithshme të kësaj thirrje janë, që Komuna e Prishtinës të ofrojë përkrahje për biznese, OJQ, programi i të cilëve është i fokusuar në fushën e kulturës, dhe ofron mbështetjen e tyre me transparencë të plotë dhe pa kurrfarë diskriminimi.

Objektivat specifike të thirrjes janë:

1. Të fuqizohen krijuesit e pavarur dhe krijuesit e rinj që veprojnë në Komunën e Prishtinës;
2. Të prodhohen punë të reja kulturore/artistike;
3. Të ketë shtrirje të gjerë dhe pjesëmarrje gjithëpërfshirëse në jetën kulturore/artistike në Komunën e Prishtinës;
4. Të sigurohet mbështetje për institucionet e pavarura kulturore që veprojnë në Komunën e Prishtinës;
5. Të mbështetet puna në grupe dhe bashkëpunimi ndër-disiplinar dhe ndër sektorial;
6. Të përkrahën punë me përmbajtje kritike, të cilat synojnë të sfidojnë pabarazi sociale dhe ekonomike;
7. Të përkrahën punë me përmbajtje Feministe;
8. Të stimulohet inovacioni teknologjik në të gjitha fushat kulturore/artistike;

9. Të inkurajohen personat me nevoja të veçanta për pjesëmarrje dhe prodhim në sektorin e artistik dhe kulturor

VLERA E PLANIFIKUAR E MBËSHTETJES FINANCIARE PËR PROJEKTET DHE SHUMA E PËRGJITHSHME E THIRRJES

- Vlera e përgjithshme e planifikuar për vitin 2024 (për dy thirrjet) është **750,000.00 €**
- Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për një projekt është **500.00€**, ndërsa shuma maksimale për një projekt është **16,500.00 €**.

MËNYRA E APLIKIMIT, PËRSHKRIMI I FUSHAVE, KUSHTET FORMALE DHE KRITERET QË DUHET PLOTESUAR APLIKANTËT

MËNYRA E APLIKIMIT

- Aplikimi bëhet përgjatë thirrjes së hapur, përmes mënyrës elektronike online <http://krs.prishtinaonline.com/>.

PËRSHKRIMI I FUSHAVE

Përshkrim i fushave në të cilat aplikanti mund ta parashikojë zbatimin e programeve apo projekteve përgjatë aplikimit:

- a) **Art vizual – figurativ:** krijim i veprës së re, fuqizim i artistëve të rinj, ekspozitë, hulumtim kuratorial, instalime në hapësira publike, mbështetje të personave me nevoja të veçanta dhe inovacion teknologjik;
- b) **Trashëgimi kulturore dhe turizëm:** fushata vetëdijësimi, pjesëmarrje në aktivitete për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, hulumtim, dokumentim, interpretim, promovim i diversitetit kulturor, turizëm kulturor, platforma informative;

- c) **Shoqëri Kulturoro Artistike:** mbështetje të aktiviteteve vjetore, blerja e kostumeve, blerja e instrumenteve dhe pjesëmarrje në festivale;
- d) **Mbështetje të aktiviteteve vjetore të organizatave dhe operatorëve kulturorë:** aktivitete mujore, fuqizim i krijuesve të rinj, rezidencë artistike, debate, ligjërata dhe hulumtime;
- e) **Botime:** për fëmijë, për të rinj, romane, tregime, përkthime, mbështetje të personave me nevoja të veçanta dhe hulumtime kulturore.

KRITERET QË DUHET TË I PLOTËSOJNË APLIKANTËT

Kriteret e përgjithshme

Për t'u kualifikuar për mbështetje financiare publike, aplikuesit duhet të plotësojnë kriteret e përgjithshme minimale të përcaktuara me dispozitat në vijim:

- të jenë të regjistruar si OJQ, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për lirinë e asocimit në organizata jo-qeveritare në Republikën e Kosovës, apo në shtetin ku është e koncentruar diaspora;
- të jenë të pajisur me numër fiskal, sipas kërkesave të legjislacionit tatimor të Republikës së Kosovës, përkatësisht dokumentacionin ekuivalent sipas legjislacionit të shtetit përkatës për OJQ-në e huaj;
- të kenë kryer të gjitha detyrimet nga mbështetja financiare paraprake, nëse kanë përfituar nga burimet publike të financimit;
- të mos ketë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete; dhe
- të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.

Lista e dokumenteve të detyrueshme të thirrjes publike

- Aplikacioni online

- **Për individ:**
 - ❖ Kopjen e letërnjoftimit/ pasaportës
 - ❖ Vërtetimin/ Konfirmimin e llogarisë bankare (nuk pranohet kopje e kartelës bankare);
 - ❖ Certifikatën/ Vërtetimin e vendbanimit (merret në zyrat e gjendjes civile apo në bashkësi lokale)
- **Për Ojq-të:**
 - ❖ Certifikata e regjistrimit të OJQ-së;
 - ❖ Certifikatë e nr. fiskal;
 - ❖ Vërtetimi/Konfirmimi i llogarisë bankare të OJQ-së (nuk pranohet kopje e kartelës bankare);
 - ❖ Kopjen e letërnjoftimit/ pasaportës të përfaqësuesit të OJQ-së;
 - ❖ Vërtetimin që OJQ-të nuk kanë obligime tatimore (nga ATK).
- **Për Biznese:**
 - ❖ Certifikatë e Biznesit (me Numër Unik Identifikues nga ARBK);
 - ❖ Vërtetimi/Konfirmimi i llogarisë bankare të Biznesit (nuk pranohet kopje e kartelës bankare);
 - ❖ Kopjen e letërnjoftimit/ pasaportës të përfaqësuesit të Biznesit;
 - ❖ Vërtetimin që Bizneset nuk kanë obligime tatimore (nga ATK).

Lista e dokumenteve specifike të thirrjes publike sipas kategorive:

1. Art Figurativ:

- a. Portfolio e artistit/es/kolektivit;
- b. Prezentim i punimeve që do të ekspozohen;
- c. + (Për instalacione/skulptura/intervenime ne hapësirë publike);
- d. Koncepti vizual i veprës;

- e. Pëlqimi paraprak prej drejtorisë për shërbime publike për lokacionin e veprës.

2. Trashëgimi kulturore dhe turizëm:

- a. Portfolio e organizatës me punë të ngjashme ose linqe të punëve të ngjashme të autorit-es;
- b. Projekt propozim (Preferohet që në projekt të ketë profesionist të fushës së trashëgimisë dhe të turizmit);
- c. Koncepti vizuel (aty ku është e zbatueshme);
- d. Ftesa/marrëveshja (kur aplikohet për pjesëmarrje në aktivitete dhe hulumtime);

3. Shoqëri Kulturo- Artistike:

- a. Link i punëve të mëhershme të SHKA-ve;
- b. Biografi të shkurtër për ekipet e përfshira në projekt;
- c. Koncepti i programit artistik(Përshkrim i detajuar);
- d. Ftesa/marrëveshja (kur aplikohet për pjesëmarrje në aktivitete).

4. Mbështetje të aktiviteteve vjetore:

- a. Link i punëve të mëhershme të organizatës;
- b. Biografi të shkurtra për individët/ekipet e përfshira në projekt;
- c. Plani i punës për vitin aplikues (Të përshkruhen detajet e gjitha aktiviteteve);

5. Botime:

- a. Biografia e autorit/es;
- b. Recenzioni;
- c. Një pjesë e veprës që do të botohet (Nëse ka ilustrime për fëmijë);
- d. Prezantim i ilustrimeve;
- e. (Nëse ka) Marrëveshje e nënshkruar me shtëpinë botuese.

KUSHTET FORMALE TË THIRRJES

Shpenzimet e pranueshme që do të financohen përmes thirrjes

Përmes fondeve publike të kësaj thirrjeje publike, mund të financohen vetëm kostot reale dhe të pranueshme për realizimin e aktiviteteve të projektit, në periudhën kohore të specifikuar me këto udhëzime. Në vlerësimin e projektit/programit, do të vlerësohen vetëm kostot e nevojave në lidhje me aktivitetet e planifikuara, si dhe në lartësinë reale të këtyre shpenzimeve.

Shpenzimet e papranueshme përfshijnë:

- Blerja e pajisjeve për zyra;
- Renovime të objekteve;
- Dhurata, mirënjohje dhe shpërblime të ngjashme.
- Shërbime administrative (pagesa e qerasë, derivateve, ujit, rrymës, telefonit, internetit, mirëmbajtja e llogarisë bankare etj).

Llojet e mëposhtme të aktiviteteve nuk janë të pranueshme për financim:

- Aktivitete që nuk zhvillohen në komunën e Prishtinës;
- Aktivitete që përmbajnë diskriminim gjinor;
- Aktivitete që përmbajnë diskriminim fetar.

PERIUDHA E ZBATIMIT TË PROJEKTIT

- Periudha e zbatimit të projektit është deri *në fund të muajit Dhjetor, 2024.*

DORËZIMI I APLIKACIONIT

- Aplikacionin mund ta dorëzoni vetëm përmes mënyrës elektronike, online <http://krs.prishtinaonline.com/>,
- Aplikacionet në formë tjetër nuk pranohen.

- Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike, mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: kultura.pr@rks.gov.net. Pyetjet mund të bëhet deri më **15.04.2024**.
- *Afati për dorëzimin e propozimeve është deri më **24.04.2024, ora 23:59**, përmes aplikacionit online, në dispozicion në faqen e internetit të Komunës së Prishtinës <http://krs.prishtinaonline.com/>*
- **Për ndihmë shtesë lidhur me mënyrën e aplikimit ju lutem klikoni në vegzën <https://www.youtube.com/watch?v=yZezaokdi4E>**